



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

AD/GJTHPE/.nr.10/23

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, me Kryetarin e Gjykatës Armend Berisha, në procedurën disiplinore ndaj gjyqtarit B.A, duke vepruar sipas ankesës disiplinore të parashtruar nga I.H, nga J., me banim në lagjen “Q.” pn, pas shikimit të shkresave dhe vlerësimit të ankesës, jashtë seancës, me datë 20.11.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET ankesa disiplinore e parashtruar nga I.H, nga J., ndaj gjyqtarit B.A, **SI E PABAZUAR.**

A r s y e t i m

Me datë 02.11.2023, Këshilli Gjyqësor i Kosovës konform nenit 9 par.1 pika 1.1 lidhur me par.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka përcjellë të Autoriteti Kompetent ankesën disiplinore të parashtruar nga I.H, nga J., me banim në lagjen “Q.” pn, ndaj gjyqtarit B.A, me arsyetimin se në lëndën C.nr.50/2014, ku paditës është parashtruesi i ankesës disiplinore, gjyqtari B.A e ka injoruar sulmin e tij fizik, duke mos i përmendur askund lëndimet që i janë shkaktuar me qëllim që ta mbrojë dhe ta arsyetoj sulmuesin e këtui parashtruesit të ankesës disiplinore, i njëjti pa arsye dhe përgjegjësi ligjore i shtynë seancat gjyqësore në lëndën C.nr.50/14 e cila pas revizionit ka marrë numrin C.nr.477/2023 ashtu që, kjo lëndë ka zgjatë dhjetë (10) vite, nga viti 2014 deri në vitin 2023. Po ashtu, parashtruesi i ankesës ka theksuar se gjyqtari A. shoqërohet me të paditurin, komunikon ex-parte para dhe pas seancave, e këshillon dhe e ka mik sepse bashkëshortja e gjyqtarit është shoqe e ngushtë dhe kolege e punës me bashkëshorten e të paditurit dhe se gjyqtar porot në këtë çështje është burri i tezes së të paditurit dhe se seancat gjyqësore i mban pa porotë prezent sepse e fsheh gjyqtarin porot që është familjar i të paditurit, arsye këto për të cilat parashtruesi i ankesës thekson se disa herë ka kërkuar përjashtimin e gjyqtarit por, i njëjti asnjëherë nuk e ka raportuar. Parashtruesi i ankesës ka shtuar se gjyqtari B.A, nuk ka etikë profesionale, është i njëanshëm dhe nuk është i pavarur por, vepron ashtu si i thotë partia e bashkëshortes së tij dhe se këtu parashtruesin e ankesës e trajton me inferioritet duke ja anashkaluar deklaratat dhe tani e dhjetë vite që zgjat ky gjykim asnjëherë nuk e ka pyetur cili ka qenë motivi i të paditurit për t’a sulmuar, nuk i pranon dokumentacionin mjekësor si provë dhe e lejon të paditurin t’a ofendoj, fyej dhe shpif për paditësin në çdo seancë ndërsa, gjyqtari e mbështet dhe e nxitë të paditurin që t’a denigroj personalitetin e tij dhe duke manipuluar qe dhjetë vite në të gjitha seancat gjyqësore, i njëjti nuk siguron rregull, siguri as paqe gjatë seancave gjyqësore, nuk i mban seancat në sallë të gjykimit por në zyrën e tij dhe me të paditurin që është 50 cm larg paditësit, me qëllim që ti shkaktohet trysni dhe frikë andaj, ka propozuar që gjyqtari të suspendohet me qëllim që të mos abuzoj më tutje me ligjin.

Me datë 03.11.2023, Kryetari i Gjykatës duke vepruar në kuptim të nenit 9 par.5 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve e ka njoftuar Këshillin Gjyqësor të Kosovës për pranimin e ankesës disiplinore të parashtruar nga I.H, ndaj gjyqtarit B.A.

Gjyqtari B.A, në deklaratën e tij të dhënë me shkrim lidhur me pretendimet e parashtruesit së ankesës ka deklaruar se pretendimi i parashtruesit të ankesës se lënda C.nr.477/2023, nuk është marrë në shqyrtim më shumë se 10 vite, është pretendim i pabazuar meqë në këtë çështje janë ndërmarrë një mori veprimesh nga gjykata e shkallës së parë, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme, pasi këtu parashtruesi i ankesës disiplinore vetë ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit dhe revizion në Gjykatën Supreme dhe se lidhur me faktin se pala ka tituj akademik dhe shkencor, gjyqtari ka theksuar se si gjyqtarë gjatë gjykimit palët në procedurë i trajton në mënyrë të barabartë ndërsa, lidhur me pretendimin e ankuesit se gjyqtari komunikon me palët ex-parte, i njëjti ka sqaruar se pretendimi i tillë nuk qëndron duke sqaruar se paditësi i ka të gjitha mundësitë ligjore që të kërkoj përjashtimin e gjyqtarit nga lënda. Sa i përket pretendimit të ankuesit se bashkëshortja e gjyqtarit e ka mik të paditurin dhe personat e tjerë, i njëjti nën përgjegjësi penale ka deklaruar se persona në fjalë nuk i ka miq, të afërm, familjar apo krushq, as ai e as bashkëshortja e tij. Gjyqtari ka sqaruar se qëndron pretendimi se paditësi, këtu parashtruesi i ankesës, ka parashtruar kërkesë për përjashtim të gjyqtarit nga gjykimi dhe vendosja në çështjen e tij mirëpo, kërkesa për përjashtim është refuzuar nga Kryetari i Gjykatës. Përfundimisht, gjyqtari ka shtuar se sa i përket pretendimeve të parashtruesit të ankesës se gjyqtari nuk është i pavarur, nuk ka etikë profesional edhe është i ndikuar nga politika, të njëjtin e fton që nëse ka bazë pretendimet e tilla t'i paraqesë para organeve kompetente.

Kryetari i Gjykatës duke vlerësuar ankesën e parashtruar ndaj gjyqtarit B.A, së bashku me deklaratën e tij, ka gjetur se ankesa disiplinore nuk është e bazuar.

Autoriteti kompetent me vëmendje ka vlerësuar pretendimet e parashtruesit të ankesës se lënda në të cilën parashtruesi i ankesës është palë paditëse ka zgjatur për dhjetë (10) vite pasi gjyqtari pa arsye i shtynë seancat gjyqësore, komunikon ex parte me të paditurin si dhe të njëjtin e këshillon dhe e ka mik mirëpo, ka gjetur se pretendimet e tilla të ankuesit janë të paargumentuara dhe të pambeshtetura në asnjë provë të vetme. I njëjti, po ashtu me asnjë provë nuk i ka argumentuar pretendimet e tij se gjyqtari nuk ka sjelle etike, është i njëanshëm, nuk është i pavarur dhe është i ndikuar nga politika e pretendimet e tjera të ngjashme andaj, deklaratimet e tilla si të vetme dhe të pa argumentuara me asnjë provë nga ana e parashtruesit të ankesës, nuk mund të merren për bazë për iniciimin eventual të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit.

Lidhur me pretendimin e parashtruesit të ankesës se gjyqtari B.A seancat gjyqësore i mban pa prezencën e gjyqtarëve porotë sepse e fsheh gjyqtarin porotë i cili është burri i tezes së të paditurit, autoriteti kompetent e vlerëson se është e arsyeshme të sqarohet se çështja juridiko civile kontestimore të cilës i referohet këtu parashtruesi i ankesës disiplinore, ka bazë juridike kompensim dëmi dhe konform ligjit, lëndët e kësaj natyre në gjykatë gjykohet nga gjyqtari i vetëm profesional dhe në asnjë fazë të saj nuk kërkohet pjesëmarrja e gjyqtarëve porotë andaj, pretendimi i parashtruesit të ankesës për shkelje disiplinore mbi këtë pikë është tërësisht i pabazuar.

Sa i përket pretendimeve të ankuesit se ka kërkuar përjashtimin e gjyqtarit, mirëpo gjyqtari nuk e ka raportuar kërkesën e paditësit për përjashtim, autoriteti kompetent gjen se pretendimi i tillë është në kundërshtim me shkresat e lëndës nga të cilat rezulton se Kryetari i Gjykatës ka vendosur për kërkesat e paditësit për përjashtim të gjyqtarit.

Nga arsyet e theksuara me lartë, konform dispozitave ligjore të nenit 9 par.6 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe nenin 7 par.3 pika 3.2 të Rregullores të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, AD/GJTHPE/.nr.10/23, me datë 20.11.2023.

Kryetari i Gjykatës

Armend Berisha

Vendimi i dorëzohet:

- 1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës*
- 2. Gjyqtarit B.A*
- 3. Parashtruesit të ankesës – I.H, nga J.*